

## **Komunikatë për shtyp** **31 maj 2007**

### **Anketa e AKM-së tregon sukses të privatizimit**

**PRISHTINË** – Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM) sot ka publikuar një anketë mbi suksesin e privatizimit. Zëvendës Drejtori Menaxhues i AKM-së, Ahmet Shala, përgjegjës për Ndërmarrjet Shoqërore, tha në një njoftim për mediat se rezultatet e kësaj ankete tregojnë “progres shumë real në sektorin privat” në Kosovë. Drejtori i Privatizimit në AKM, Kirk Adams, ka vlerësuar programin e privatizimit si një hap thelbësor fillestar për zhvillimin e këtij sektori.

“Anketa e Post-Privatizimit” e përpiluar nga AKM-ja ka ekzaminuar 50 ndërmarrje të vogla dhe të mesme gjatë dy javëve të fundit. Blerësit e kompanive nuk i janë nënshtruar kushteve të posaçme dhe kështu kanë mundur të vendosin lirisht se si ta shfrytëzojnë pronën.

Anketa ka treguar se të hyrat mesatare në ndërmarrje të reja janë rritur për shtatë herë prej privatizimit të tyre. Investimet e planifikuara në infrastrukturën kapitale të ndërmarrjeve tejkalojnë shumë €150,000. Një numër i konsiderueshëm i vendeve të reja të punës është krijuar. “Punësimi i vërtetë që paguhet për punë që vërtetë kryhen është rritur për 7%”, tha Adams.

Adamsi tha se dhënia e pasurive shoqërore në sektorin privat ka çuar në rritje të rëndësishme të eksportit gjatë tre viteve të fundit. “Ekonomia është zhbllokuar dhe procesi i privatizimit ka luajtur rol mjaft të madh në këtë.”

Ai theksoi se jo çdo ndërmarrje e re ka qenë sukses por rezultatet e përgjithshme janë pozitive. “Merita më e madhe i takon popullit të Kosovës, shpirti ndërmarrës i të cilëve ka ndihmuar që kompanitë të zhvillohen.” Adamsi theksoi se roli i AKM-së ishte që të ruaj dhe rris vlerën e ish ndërmarrjeve shoqërore nën mandatin e saj të mirëbesimit “Kjo anketë tregon se me ndihmën e njerëzve të Kosovës, kemi arritur mjaft në rrugën për arritjen e kësaj” tha ai.

### **FUND**